



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës

12 Nr. 060/04-35213 dt. 30.07.2021

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. 23.07.2021, ora 10:00.

Mbledhjen ë kryesoi: Labinot Halilaj- Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa ku të pranishëm ishin anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Gani Podrimqaku, Florentina Elezi, Fitore Morina, Burim Bujupi si dhe prezent gjatë këtij takimi ishin: Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci si dhe Drejtor të Drejtorive Komunale. Munguan Blerina Gashi dhe Edolina Plakiqi.

Komiteti filloi punimet më këtë:

Rënd dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt. 18.06.2021.
2. Informim i kuvendit për aktivitetet e KKS-së.
3. Raporti financiar i zhvillimit të Buxhetit Janar- Qershor 2021.
4. Bartja e mjeteve nga Rezerva Buxhetore për projektin digjitalizimi i shkollave.
5. Të ndryshme.

Kryesuesi e Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, pasi përshëndeti të pranishmit, deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa, ku prezantoi rendin e ditës.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- më konfirmuan se do ta kemi edhe një pikë shtesë për mbledhjes e rregullt të kuvendit: 1. Propozim vendim për emërtim të rrugëve, materialin nuk e kemi ende të gatshme por besoj që për kuvend do ta përgatitim, dhe 2. Bartja e mjeteve nga Rezerva Buxhetore për projektin digjitalizimi i shkollave.

Burim Bujupi, ne si komision i kemi shqyrtuar gjitha kërkesat neper fshatrat, vetëm se në sistem kemi mbet pak me ngecje, jemi në përfundim e sipër por besoj qe të hënën do t'i përfundojmë të gjitha për mbledhjen e radhës.

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi hodhi në votim rendin e ditë se bashku me këto pika shtesë që u ceken me lartë, prezent gjatë votimit ishin 5 anëtar dhe votuan në mënyrë anonime të gjithë anëtarët e KPF-ca.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës:
1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt. 18. 06.2021.

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime, kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent ishin 5 anëtar dhe votuan në mënyrë anonime të gjithë anëtarët e KPF-ca, *për votuan 5, 00 kundër, 00 abstenim*

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës:
2. Informim i kuvendit për aktivitetet e KKSB-së.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- e kemi berë një raport ku e shihni edhe ju, ne e kemi obligim ligjor me i mbajt dy mbledhje i kemi mbajt mbledhjet, temat që janë diskutuar i keni këtu, dhe kjo hyn ne kuadër të performancës komunale.

Burim Bujupi- kërkoj një sqarim për piken nr.6, për qentë endacak sepse kemi shumë ankesa nga qytetaret, çka ka ndodh?

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- ju e dini që përgjegjësi tri vitet e kaluara deri të fund te qershorit ose gjysmë korrikut e ka pas për obligim niveli qendror, buxhetin që e kanë pas komunat i kane marrë dhe e kanë pas ata, tani më nuk e kanë ata i kemi ne, e kemi një shumë të mjeteve dhe janë në dispozicion për trajtimin e qeneve endacak, jemi duke i trajtuar në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjente.

Burim Bujupi- a ka ndonjë kontratë me veterinar për trajtimin e qeneve endacak, sepse ne fshatin tonë e kane marrë një qen dhe e kanë trajnu edhe e kanë lëshuar a është i rrezikuar ai qen apo jo?

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- nëse e ka marrë në trajtim qenin dhe ka vath ai nuk është i rrezikshëm.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës:
3. Raporti financiar i zhvillimit të Buxhetit Janar- Qershor 2021.

Drejtori i Financave Shyqeri Bublaku- sa i përket raportit financiar janar-qershor 2021, ky raport është si obligim ligjor i cili kuvendi komunal është i obliguar me e trajtu për çdo 3 mujor. Realizimi i të hyrave për 6 mujorin e parë 2021 është në shumë prej 567,733,45 € për të hyrat direkte që realizohen nga komuna jonë, ndërsa përqindja është 86.90% , realizimi i të hyrave direkte dhe indirekte është ne shumë prej 1,200,051,35 € këtu hyn edhe gjrobat e komunikacionit, gjykatës dhe grandët e performances, buxheti i planifikuar për të hyrat vetanake për vitin 2021 është 1,306,660,00 €. Realizim e të hyrave kemi kryesisht me shume në tatim ne pronë që është një rezultat shumë i mirë,

sa i përket realizimit të buxhetit po e paraqes në pika të shkurta, për paga buxheti është shpenzu 99.96 %, për mallra dhe shërbime 45.42 %, për shpenzime komunale 72.04 %, për subvencione 67.37%, investimet kapitale 12.43 %, shuma e përgjithshme e buxhetit të alokuar është 53.75 % është në parametrat që kemi planifikuar me e mrri realizimin e buxhetit prej 15,399,334,00 €, kemi pas ngecje sidomos të investimet kapitale është normale për periudhën për të cilën po raportojmë, është hapja e tenderëve, caktimi i operatoreve ekonomik, koha e cila ka ndiku edhe moti janë gjitha këto probleme që kemi hasur gjate vitit 2021.

Florentina Elezi- në Drejtorinë e Infrastrukturës shumë pak ka të hyra 5.57 % shumë pak është realizuar.

Drejtori i Financave Shyqeri Bublaku-buxheti nuk alukohet deri në muajin e tretë, implementimi fillon pas muajit të trete tani janë duke u realizuar projektet dhe deri ne fund te vitit nuk bëhet shpenzimi i buxhetit.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës: **4. Bartja e mjeteve nga Rezerva Buxhetore për projektin digjitalizimi i shkollave.**

Drejtori i Arsimit Muhamet Gjoka- ju njoftoj se kjo pike e rendit te ditës vetëm është votuar ne kuvend gjatë vitit të kaluar ne kuadër të projekteve kapitale mirëpo si projekt i ri nga ministria e financave është vendos ne rezerve buxhetore për me mujt me e zhvillu si projekt këtë vit neve na duhet edhe një herë aprovimi i kuvendit qe me mujt me vazhdu me projektin e digjitalizimit te shkollave, dhe shtrirjen e internetit ne shkolla, dhe me fillu sa më shpejt që është e mundur.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, pasi që nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime e hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, dhe votuan në mënyrë anonime të gjithë anëtarët e KPF-se me 5 vota për, 00 kundër, 00 abstenim.

Gani Podrimqaku, hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: **5. Propozim vendim i komisionit për emërim të rrugëve.**

Pasi që nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime e hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, dhe votuan në mënyrë anonime të gjithë anëtarët e KPF-se me 5 vota për, 00 kundër, 00 abstenim.

Gani Podrimqaku, hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Të ndryshme

Nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime.

Mbledhja përfundoj rreth orës: 10:55 min

PROCESMBAJTTËSE:



Liridona Fejza-Ajazi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal


Labinot Halilaj